



## AKT THEMELIMI

### I

## SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

### “ B L E T A ”

---

Do te krijohet nje shoqeri tregtare me pergjegjisi te kufizuar nga deshira dhe vullneti i lire i themeluesve te saj :

- 1. Bledar Rrushi ,** i biri i Agimit, dtl.25.12.1980, lindur ne Durres, banues ne lagjen nr 9, rruga “A.Goga” pall.897, Durres, me numer pasaporte Z0520277
- 2. Arian Simo** i biri i Nikos, i dtl.30.12.1982, lindur ne Durres, banues ne lagjen nr1, tek dy kullat, me nr.pasaporte Z1634794
- 3. Theoharis Papa** i biri Kostandinit, i dtl.1983, lindur e banues ne Durres, lagja nr 17, rruga “D.Peza” nr.pasaportes Z0905601

te cilet ne veprimtarine e tyre tregtare, ekonomike e prodhuese do te udhehiqet nga zbatimi i ligjit „ Per shoqerite tregtare” nga K.Civil si dhe te gjithë aktet e normat juridike qe rregullojne mardhenjet e shoqerise me te trete e ndermjet tyre.

## Emertimi

Shoqeria e porsa krijuar do te emertohehet "B L E T A" ,(sh.p.k.)  
e cila do te jete me pergjegjsi te kufizuar,dhe do te pergjigjet per humbjet  
e saj deri ne kufirin e kapitalit themeltar.

## S e l i a


---

Shoqeria tregtare " B L E T A"(sh.p.k.),seline saj do te kete ne  
Ne Durres,lagja nr 17,Rruga "Dalip Peza" prane zyrave te ujesjellesit  
o Qendren e saj perative te saj do ta kete ne te njejtin vend  
e cili mund te ndryshoje sipas objektit qe do te kete per aktivitetin e  
saj shoqeria,duke hapur dege dhe filiale te saj ne te gjithe vendin si  
dhe jashte tij.

## Objekti I Veprimtarise

---

Objekti I veprimtarise se shoqerise do te jete :  
Tregtimin ,shitblerjen me shumice e pakice,brenda dhe jashte vendit  
Import export,te mallrave e produkteve,ushqimore,bujqesore,industriale,  
elektrike,elektroshtepiake,hidrosanitare,drusore,,ndertimore,mobilare,  
kancelarie, pjese kembimi per sistemin informatik te kompjuterizuar.  
Si dhe pjese per mediat visive e audiovisive.  
Sherbim interneti(ISP)  
Transport mallrash te ndryshem per vehte dhe te trete,brenda dhe  
Jashte vendit,per vehte dhe te trete.



## Kapitali i shoqerise

---

Kapitali themeltar I shoqerise do te jete 100.000 leke,I ndare ne 100 pjese,teresisht te nenshkuara e te shlyera,duke patur sejcila prej tyre nje vlere nominale per 1000 leke.Fondet e ardhura nga derdhja ne para nga ortaket depozitohen prane Bankes private Durres.Kontributi ne pjese e ne perqindje eshte :


1. Bledar Rushi ,shumen prej 33.000 leke,qe i takon 33% e kapitalit ose 33 pjese dhe cdo pjese e tij eshte e barabarte me 1000(njemije)lek.
- 2.Arjan Simo, shumen prej 33.000 leke,qe i takon 33% e kapitalit ose 33 pjese dhe cdo pjese e tij eshte e barabarte me 1000(njemije) lek.
- 3.Theoharis Papa, shumen prej 34.000 leke,qe i takon 34% e kapitalit ose 34 pjese dhe cdo pjese e tij eshte e barabarte me 1000 (njemije) lek.

i Ortaket perballon humbjet e e shoqerise vetem,deri ne kufirin e vleres se kontributit te saj ne kapitalin themeltar.

## Kohe zgjatja

---

Kohe zgjatja e veprimtarise se shoqerise eshte per 10 vjet kohe. e cila sipas vendimit te ortakeve themelues te saj,mund te shtyhet me tej ose mund te shperndahet ne cdo kohe simbas percaktimit te bere ne statutin e shoqerise.



## Administrimi I shoqerise

Shoqeria eshte me pergjegjsi te kufizuar dhe pergjigjet per humbjet E saja deri ne kufirin e kapitalit themeltar.

Per drejtimin e puneve te shoqerise eshte caktuar dhe Administratori i saj, qe eshte ortaku **Bledar Rushi**

Organi drejtues i shoqerise eshte, Asamblea e ortakeve dhe Administratori unik i saj, te cilet zhvillojne veprimtarine e tyre ne per-puthje me statutin e shoqerise dhe ligjet perkatese.

## Bilanci dhe te ardhurat

Viti financiar i shoqerise do te filloje me daten 1 Janar dhe do te perfundoje me daten 31 Dhjetor te cdo viti.

Bilanci vjetor do te nxirret nga eksperti kontabel dhe do te miratohet nga asamblea, e cila do te beje miradministrimin e shperndarjen e fitimit.



Zgjidhja e mosmareveshjeve

---

Nese ne shoqeri do te lindin mosmareveshje ndermjet  
Ortakeve dhe te punesuarve dhe ato nuk zgjidhen me pajtim  
Palet e drejtohen gjykates per shqyrtim te konfliktit.

ORTAKET THEMELUES

Bledar Krushci  
*[Signature]*

*[Signature]*  
Theodoris Papa

*[Signature]*  
Arian Simo  
(Perfaqesuesi me prokure  
i tij Theodoris Papa)



# STATUTI

## I

### SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

#### „ B L E T A „

---

Mbeshtetur ne ligjen 7638 date 19.11.1992,Per shoqerite tregtare” si dhe ne aktin e themelimit :

1. **Bledar Rrushi**, i biri i Agimit,I dtl 1980,lindur ne Durres dhe banues ne Durres,lagja nr9 Rruga « A.Goga »pall 897,me numer te Pasaportes Z0520277.
  
2. **Arian Simo** i biri i Nikos, i dtl 1982,lindur e banues ne Durres,lagja nr 1,rruga « Taulantia » me nr.pasaporte Z1634794.
  
- 3.**Theoharis Papa** i biri Kostandinit,i dtl 1983,lindur e banues ne Durres,lagja nr 17,rruga « D.Peza »me pasaporte nr Z0905601.

Krijojne nje shoqeri tregtare me pergjegjisi te kufizuar sa me poshte :

## Formimi

---

### Neni 1

---

Eshte krijuar nje shoqeri me pergjegjsi te kufizuar nga vullneti dhe deshira e lire e themeluesit te saj e cila do te rregullohet nga ky statut dhe akti themelues i saj. Shoqeria do te veproje sipas legjislacionit shqiptar ne fuqi. Akti themelimit dhe statuti i saj jane ne konformitet me ligjen shqiptare, me karakter te detyrueshem dhe plotesohen, per aq sa ne to nuk eshte parashikuar ne ligj.

## Emertimi

---

### Neni 2

---

Emertimi i shoqerise do te jete "B L E T A"(sh.p.k.) Durres

## Kohe zgjatja

---

### Neni 3

---

Veprimtaria ekonomiko tregtare e shoqerise „B L E T A ”(sh.p.k.) Durres do te jete per nje afat kohor 10 vjecar, e cila mund te shtyhet ose pakesohet me vendim te Asamblese se ortakeve.

## Selia

---

### Neni 4

---

Seline saj legale shoqeria do ta kete ne Durres, lagja nr 17, rruga "D.Peza" afer



Drejtorise se ujesjellesit.  
Qendra operative e saj do te jete po ne te njejtin vend.  
Shoqeria mund te hape filiale,dege ose perfaqesi te saj  
ne rrethe ose jashte shtetit,sipas vendimit te asambles.

### Objekti i veprimtarise

#### Neni 5

Objekti veprimtarise se shoqerise do te jete I percaktuar sa me poshte  
- Tregtimin,shitblerjen me shumice e pakice,brenda dhe jashte  
vendit,import export,te mallrave e produkteve ushqimore,bujqesore,  
industriale,elektrike,elektroshtepiake,hidrosanitare,drusore,ndertimore,  
,kancelarie,pjese kembimi per sistemin informatik te kompjuterizuar  
si dhe pjese per mediat visive e audiovisive.  
Sherbim interneti (ISP)  
Transport mallrash te ndryshem,per vehte dhe te trete,Brenda dhe jasht  
Vendit.


### Kapitali I shoqerise

#### Neni 6

Kapitali themeltar I shoqerise eshte 100.000 leke,I ndar  
ne 100 pjese teresisht te nenshkruara e te shlyera,duke  
patur sejcila prej tyre nje vlere nominale prej 1000 leke  
fondet e ardhura nga derdhja ne para nga ortaket depo-  
-zitohet prane Bankes Credins Durres,me numer llogarie te  
vecante ne emer te shoqerise.

Kontributet ne pjese e perqindje eshte si me poshte :

- |                        |  |
|------------------------|--|
| <b>1. Bledar Rushi</b> | lek 33.000 ,qe i takon 33<br>pjese,ose 33 % e kapi-<br>-talit themeltar. |
| <b>2. Arian Simo</b>   | lek 33.000, qe i takon 33 pjese<br>ose 33% e kapitalit themeltar.        |



3. Theoharis Papa,

lek 34.000, qe i takon 34 pjese  
ose 34 % e kapitalit themeltar.

Ortaku perballon humbjet e shoqerise vetem, deri ne  
Kufirin e vleres se kontributit te tij ne kapitalin themelues te shoqerise.

#### Neni 7

---

Kapitali themeltar mund te shtohet pa kufi, ne cfardo momenti,  
nje ose me shume here, me vota te shprehura ne  
Asamblene e ortakeve, te pranishem ose te perfaqesuar  
qe zoterojne te pakten  $\frac{3}{4}$  e kapitalit themeltar.  
Ne rastin kur vendoset shtimi I kapitalit, te gjitha ortaket  
kane te drejte te nenshkruajne shtimin ne raport me pje-  
-set e kapitalit qe zoterojne. Ne rast se nuk e ushtrojne kete  
te drejte, pjeset e tyre mund te nenshkruhen nga ortaket e  
tjere ne menyre proporcionale sipas kuotave qe ata  
zoterojne.

#### Neni 8

---

Zvogelimi i kapitalit themeltar, i cili dhe ky behet me vendim  
te asamblese se ortakeve, neprmet votimit te ortakeve  
te pranishem ose te perfaqesuar qe zoterojne  
se paku  $\frac{3}{4}$  e kapitalit themeltar.

#### Neni 9

---

Pjeset mund te transferohen te treteve teresisht ose pjeserisht  
vetem me vendim te asamblese se ortakeve, qe perfaqesojne  
te pakten  $\frac{3}{4}$  e kapitalit themeltar.  
Kapitali eshte lirisht I transferueshem ne rruge trashegimie  
ose ne rast ndarje te pasurise bashkeshortore  
Ne cdo rast pjeset duhet ti afrohen me perparesi ortakeve, vetem  
ne rast se ata heqin dore, do tu kalohet te treteve, me kusht qe tran-  
-sferimite mos jete me i leverdisshem per bleresin ne raport me  
ato te propozuare ortakeve.



## Administrimi I shoqerise

---

Neni 10

Organi vendimor I shoqerise eshte Asamblea e Ortakeve. Vendimet e saj te mara nga shumica e votave jane te detyrueshme per ortaket.

Neni 11

Cdo ortak ka te drejte te mare pjese ne asamble, te paraqese mendimin dhe te shprehe aq vota sa jane pjeset e kapitalit themeltar te derdhura nga ai.

## Procedurat e mbledhjes se asamblese

---

Neni 12


Asamblea e ortakeve eshte organi me I larte drejtues I shoqerise. Ajo perbehet nga teresia e pjeseve qe zoterojne ortaket e shoqerise nga kapitalet e derdhura prej tyre. Asamblea eshte e zakoneshme dhe e jashtezakoneshme.

Neni 13

Asamblea mbliidhet ne seline e rregjistruar te shoqerise, e ne pa mundesi, ne nje vend tjeter te pershtatshem.

Neni 14

Te drejten e thirjes se asamblese e kane :  
Administratori  
Njeri nga ortaket e shoqerise. Likujdatoret.



Neni 15

---

Asamblea e zakonshme duhet te thiret se paku nje here ne vit, brenda 15 diteve nga mbyllja e vitit ushtrimor per aprovimin e bilancit, te relacioneve te Administratorit, te ekspertit kontabel si dhe per inventarin.

Asamblea e jashtezakonshme, jo me pare se 3 muaj nga data e meparshme e mbledhjes se asamblese

Thirja e mbledhjes se asamblese behet sipas procedurave ligjore duke percaktuar dhe llojin e e asamblese.

Ortaket mund te perfaqesohen nga ortaket e tjere ose nga te trete sipas autorizimit te vecante te leshuar prej tyre.

Neni 16

---

Asamblea trajton te gjitha problemet qe kane te bejne me aktivitetin e saj dhe per nga rendesia qe ato kane mund te jene te zakonshme dhe te jashtezakonshme.

Asamblea e zakoneshme trajton te gjitha ceshtjet, qe nuk vendosen nga asamblea e jashtezakoneshme, te percaktuara nga statuti ose ligji, si, Emerimin dhe revokimin e administratoreve, te ekspertit kontabel, aprovon planet e prodhimit, tregtimit e tjere. Organizimin dhe zhvillimin e veprimtarise dhe bilancin preventiv, bilancet perio-dike te vitit ushtrimor. Relacionet e Administratorit dhe te ekspertit kontabel, inventarin. Vendos mbi shperndarjen e fitimeve.

Asamblea e zakoneshme eshte e vlefshme dhe mund te vendose nese eshte prezent ose e perfaqesuar me shume se 50% e kapitalit themeltar te shoqerise.

Ne rast se nuk sigurohet kjo shumice, asamblea duhet te mblidhet per here te dyte dhe mund te mbahet e te vendose me shumice, cilido qe te jete numuri i ortakeve prezent ose te perfaqesuar dhe votues, pervec rastit te emerimit dhe revokimit te administratorit.

Ne kete rast ortaket e pranishem dhe votat e dhena nga ortaket qe votojne ose te perfaqesuar, duhet te kalojne 50% te kapitalit.



Neni 17

---

Asamblea e jashtezakonshme vendos per :

- Ndryshime ne aktin e themelimit e statutin e shoqerise.
  - Krijimin e filialeve te shoqerise dhe perfaqesive te saj
  - Mbi shtimin dhe zvogelimin e kapitalit te shoqerise.
  - Mbi zhvillimin e veprimtarive te reja dhe marjen pjese.
  - Mbi transferimin e pjeseve te kapitalit themeltar.
  - Mbi emerimin dhe revokimin e likujdatoreve.
  - Vendos per marje kredie
  - Miraton kontrata te rendesishme me persona te tjere juridik.
  - Percakton detyrat e administratorit dhe te drejtuesve te tjere
- Si dhe cdo kompetence tjeter qe nuk eshte e shkruajtur ne kete statut por qe referohet ne ligje .

Neni 18

---

Cdo asamble drejtohet nga administratori ose ndonje ortak tjeter I caktuar nga vete asamblea. Per mbajtjen e peoces verbalit caktohet nje sekretar, qofte ky dhe jo ortak. Vendimet e asamblese duhet te hidhen ne process verbal, te nenshkruhen nga administratori dhe sekretari.

Emerimi i Administratorit

---

Neni 19

---

Administratori I shoqerise "B L E T A"(sh.p.k.) dURRES ,emerohet zoti **Bledar Rushi**  
Administratori ka te gjithë fuqite per miradministrimin e zakonshem e te jashtezakonshem qe perfshihen ne objektin e veprimtarise, me perjashtim te atyre qe statuti dhe ligja ja rezervon asamblese.





**Ekspertet kontabel te autirzuar**

---

**Neni 20**

---

Kontrolli i bilancit te vitit ushtrimor dhe te librave kontabel te shoqerise do ti besohet nje eksperti kontabel te autorizuar,per nje vit kohe,i rizgjedhshem nga ortaket qe perfaqesojne mbi 50% te kapitalit,njekoheisht i revokueshem ne cdo kohe,kur konstatohet se nuk eshte ne gjendje te plotesoje detyrat e ngarkuara.

**Viti financiar e bilanci vjetor**

---

**Neni 21**

Viti financiar fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor te cdo Viti ushtrimor te veprimtarise  
Bilancet vjetore,inventari,relacioni i administratorit dhe ekspertit kontabel te emeruar,aprovohen nga asamblea me shumice votash


**Fitimet**

---

**Neni 22**

---

Fitimet neto qe rezultojne nga bilanci vjetor,pasi zbriten rezervat ligjore dhe shumat tjera te percaktuara nga asamblea,pjesa e mbetur u shperndahet ortakeve ne raport me pjeset e kapitalit themeltar,qe posedon sejcili ne menyre respective.



## Likujdimi

---

Neni 23

---

Ne rastin e prishjes shoqeria I nenshtrohet likujdimit. Per te drejtuar procedure asamblea emerone nje ose disa likujdatore, te cilet do te prezantojne relacionin perfundimtar mbi gjendjen e aktivitetit te shoqerise, mbi veprimet e likujdimit dhe afatet e domosdoshme qe duhen per te perfunduar procesin e likujdimit. Ne perfundimin e procedure se likujdimit, asamblea vendos mbi bilancin financiar perfundimtar, mbi vlefshmerine e punes se kryer nga likujdatori dhe mbi perfundimin e veprimeve te likujdimit. Pas pagimit te kreditoreve dhe marjes se kredive, likujdatori do shperndaje te ardhurat perfundimtare te likujdimit te ortakeve ne raport me pjese

## Transformimi shoqerise

---

Neni 24

---

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar mund te transformohet ne nje Shoqeri kolektive ose te nje forme tjeter vetem me aprovimin unanim te gjithe ortakeve.

Shoqeria gjithashtu mund te prishet para afatit te percaktuar ne kete statut per pamundesi veprimi, humbje te kapitalit, fuqi madhore e per cdo shkak tjeter ligjore.

## Zgjidhja mosmareveshjeve

---

Neni 25

---

Te gjithe mosmareveshjet qe lindin ne shoqeri, midis vete ortakeve, ndermjet tyre dhe te punesuarve, nese nuk zgjidhen me pajtim, kompetente eshte gjykata ne juridiksionin e te cilin kryen aktivitetin shoqeria ose i punesuari.



Neni 26

Ky statut perpilohet ne disa kopje, duke ju dhene sejcilit organ  
qe ka lidhje pune me shoqerine.

ORTAKET THEMELUES

Bledar Rrushaj  
V. Rrushaj

Theodor Papa

Arion Simo

(Perfaqesuesi i eprokurimit  
i tij Theodor Papa)